V E N D I M
Nr.110, datë 27.2.1995

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.84, DATË 26.2.1993 "PËR FINANCIMIN E DIFERENCAVE TË ÇMIMEVE TË BOTIMEVE"

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.84, datë 26.2.1993, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Shuma e financimit për vitet në vazhdim të përfshihet në buxhetin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, por jo më shumë se 3,5 milionë lekë. Subvencionimi do të bëhet për botimin e veprave të letërsisë kombëtare dhe të traditës, enciklopedike, të krijuesve të rinj e autorëve të ndaluar më parë, botimet për fëmijë e disa vepra letraro-artistike që shërbejnë për mbrojtjen e interesave kombëtarë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të nxjerrin udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi